



**VENDIM NR 7
I KESHILLIT MBIKQYRES**

Keshilli Mbiqyres i mbledhur ne daten 26.08.2011 me pjesemarrjen e zoterinjve , Helidon Begaj dhe Nazmie Poga , diskutoi mbi kete rend dite :

Shkarkimin e administratorit te ndermarjes SH.A "Buka" Tirane Zotit Abdyl Sinani dhe zevendesimin e tij me Zotin Hysen Caka.

Ku shkarkim behet ne mbeshtetje te shkreses se ministrit Nasip Naco me Nr. prot 5953/2 date 22.08.2011 "iniciuar nga nje kerkese e shumices se aksionereve qe perbejne 40 % te aksioneve , bashkengjitur si me poshte :

Qendrimi qe do te mbahet ne Asamblene e Aksionereve te dates 22.08.2011 ne SH.A. "Buka" Tirane.

- Miraton kerkesen e shumices se aksionereve per shkarkimin e administratorit aktual Z. Abdyl Sinani per shkak te moshes per pension dhe emrimin ne kete detyre te Zotit Hysen Caka.

Hidhet ne vote :

Helidon Begaj : Jam dakort me shkarkimin e Z. Abdyl Sinani dhe emrimin ne kete detyre te Zotit Hysen Caka.

Nazmie Poga : Meqenese une perfaqesoj shumicen e aksionereve dhe mendimi i tyre eshte qe te shkarkohet Zoti Abdyl Sinani , mbeshtetur dhe ne shkresen e ministrit dhe une jam dakort.

Ne zbatim te Ligjit Nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit , Neni 32 , 36 , te behen ndryshimet perkatese ne rregjister.

KESHILLI MBIKQYRES

HELIDON BEGAJ



NAZMIE

POGA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A. "BUKA" TIRANE
KËSHILLI MBIKQYRËS

V E N D I M

Nr. 3, datë 29.04.2013

Këshilli Mbikqyrës në zbatim të Vendimit nr. 642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave "Për Këshillat Mbikqyrëse të shoqërive anonime shtetërore", Udhëzimit nr. 318, datë 8.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", si dhe në mbështetje të nenit nr. 167 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar në mbledhjen e tij të datës 29.04.2013 :

V E N D O S I :

1. Lirimin e z. Hysen CAKA nga detyra e Administratorit të shoqërisë "BUKA" sh.a. Tiranë.
2. Dorëzimi i detyrës dhe ndërprerja e marrdhënieve financiare të bëhen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Emërimin e Z. Tomorr Xhani, me arsim të lartë në detyrën e administratorit të shoqërisë "BUKA" sh.a. Tiranë.
4. Marrdhëniet financiare fillojnë me paraqitjen në detyrë.
5. Ngarkohet shoqëria e "BUKA" sh.a. Tiranë për kryerjen e veprimeve përkatëse ligjore në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Kryetar


ALBERT KUSHTI

Anëtar


XHILDA QOSEJA

Anëtar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A. "BUKA" TIRANË
KËSHILLI MBIKQYRËS

V E N D I M

Nr. 7, datë 22.10.2013

Këshilli Mbikqyrës në zbatim të Vendimit nr. 642, date 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave "Për Këshillat Mbikqyrëse të shoqërive anonime shtetërore", Udhëzimit nr. 318, date 8.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikqyrës në shoqëritë anonime shtetërore", si dhe në mbështetje të nenit nr. 167 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar në mbledhjen e tij të datës 22.10.2013 :

V E N D O S I :

1. Lirimin e Z. Tomorr XHANI, nga detyra e administratorit të shoqërisë "BUKA" sh.a. Tiranë.
2. Dorëzimi i detyrës dhe ndërprerja e marrdhënieve financiare të bëhen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Emërimin e Z. Hysen CAKA, me arsim të lartë, në detyrën e administratorit të shoqërisë "BUKA" sh.a. Tiranë.
4. Marrdhëniet financiare fillojnë me paraqitjen në detyrë.
5. Ngarkohet shoqëria e "BUKA" sh.a. Tiranë për kryerjen e veprimeve përkatëse ligjore në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI MBIKQYRËS

Kryetar

Mungoh

Anëtar

Nazmiye Ropa
LS.

Anëtar

Xhulole Ronga
CR

VENDIM I KËSHILLIT TE ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË
BUKA SHA.



Tiranë më 17 Shtator, 2015.

BUKA sh.a., është një shoqëri aksionare Shqiptare, me seli në Rr. Kavajës, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ("QKR") dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve ("QRA") me NUIS J62013013A ("Shoqëria"). Shoqëria ka një kapital prej 239,000,000.00 leke, të ndarë në 283,104 aksione me vlerë nominale 844,21 lek secili.

Shoqëria në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të saj të datës 16 Shtator 2015, pas procesit të privatizimit të një pakete aksionesh në pronësi të Shtetit Shqiptar, ka miratuar Statutin e ri dhe ka emëruar Këshillin e Administrimit në përputhje me këtë Statut.

Këshilli i Administrimit përbëhet nga: (i) Znj. Brunilda Keco – Kryetare; (ii) Z. Gëzim Besholli - anëtar; dhe (iii) Znj. Laureta Myrtaj – anëtare.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit, pranojnë se kjo mbledhje është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe ata janë njoftuar rregullisht në lidhje me këtë Mbledhje dhe vendimet që do merren në të.

Rendi i Ditës:

Largimi / Shkarkimi i Administratorit aktual të Shoqërisë Z. Hysen Caka;
Caktimin e Administratorit të ri të Shoqërisë, në përputhje me Statutin e sapo-miratuar të Shoqërisë;
Autorizime.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit **Vendosin:**

1. Largimin / Shkarkimin e Administratorit Aktual **Z. Hysen Caka** me efekt të menjëhershëm;
2. Në përputhje me nenin 14.1. të Statutit të Ri të Shoqërisë, i cili përcakton se "Administratori ("Administratorët e Shoqërisë", "Administrator/ët") është person fizik, i cili mund të jetë ose jo anëtar i Këshillit të Administrimit, dhe propozohet dhe emërohet nga Këshilli i Administrimit, në përputhje me Nenin 158 të Ligjit Tregtar. ...", Administrator i Shoqërisë mund të jetë njëri prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Sa më sipër Anëtarët e Këshillit të Administrimit propozojnë dhe votojnë unanimisht që në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë për një afat 3-vjeçar të emërohet **Z. Gëzim Besholli**.
3. Autorizohet Z. Redin Popa, lindur me 23.01.1972, mbajtes i kartës ID nr. 028899819, të depozitojë këtë Vendim pranë QKR-së, QRA-së, apo pranë cdo institucioni tjetër.

Z. Gëzim Besholli, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë BUKA sh.a. do të kryejë detyrat e përcaktuara në Statut dhe konform ligjit. Asnjë Vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje, e cila përfundoi me marrjen e dy Vendimeve të sipërcituara.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Brunilda Keco

Laureta Myrtaj

Gëzim Besholli

Brunilda Keco
BKeco

Laureta Myrtaj
LM

Gëzim Besholli
GB

VENDIM I KËSHILLIT TE ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË
BUKA SH.A.

Tiranë më 08 Tetor 2018.

BUKA sh.a., është një shoqëri aksionare Shqiptare, me seli në Rr. Kavajës, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ("QKR") dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve ("QRA") me NUIS J62013013A ("Shoqëria"). Shoqëria ka një kapital prej 239,000,000.00 leke, të ndarë në 283,104 aksione me vlerë nominale 844,21 lek secili.

Shoqëria në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të saj të datës 08 Tetor 2018, ka emëruar Këshillin e Administrimit në përputhje me këtë Statut.

Këshilli i Administrimit përbëhet nga: (i) Znj. Brunilda Keco – Kryetare; (ii) Z. Gëzim Besholli – anëtar; dhe (iii) Znj. Laureta Myrtaj – anëtare.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit, pranojnë se kjo mbledhje është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe ata janë njoftuar rregullisht në lidhje me këtë Mbledhje dhe vendimet që do merren në të.

Rendi i Ditës:

Caktimin e Administratorit të ri të Shoqërisë, në përputhje me Statutin e Shoqërisë; Autorizime.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit **Vendosin:**

1. Në përputhje me nenin 14.1. të Statutit të Shoqërisë, i cili përcakton se " ... Administratori ("**Administratorët e Shoqërisë**", "**Administrator/ët**") është person fizik, i cili **mund të jetë** ose jo anëtar i Këshillit të Administrimit, dhe propozohet **dhe emërohet nga Këshilli i Administrimit**, në përputhje me Nenin 158 të Ligjit Tregtar. ...", Administrator i Shoqërisë mund të jetë njëri prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit.
Sa më sipër Anëtarët e Këshillit të Administrimit propozojnë dhe votojnë unanimisht që në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë për një afat 3-vjeçar të emërohet **Z. Gëzim Besholli**.

2. Autorizohet Z. Lluke Nika, lindur me 09/11/1991, mbajtes i kartës ID nr. 028166044, të depozitojë këtë Vendim pranë QKR-së, QRA-së, apo pranë cdo institucioni tjetër.

Z. Gëzim Besholli, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë BUKA sh.a. do të kryejë detyrat e përcaktuara në Statut dhe konform ligjit. Asnjë Vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje, e cila përfundoi me marrjen e dy Vendimeve të sipërcituara.

Kryetar

Brunilda Keco



Anëtar

Laureta Myrtaj



Anëtar

Gëzim Besholli



Shoqëria "BUKA" Sh.a.
NIPT J 62013013 A
Rruga e "Kavajës", Tiranë

VENDIM
I ASAMBLESË SË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË

"BUKA" SH.A.

datë 05.02.2014

Sot më datë 05.02.2014, Asambleja e aksionarëve të shoqërisë "BUKA" Sh.a., pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme të shoqërisë, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në ato të Statutit të shoqërisë,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së privatizimit të paketës shtetërore, në SH.A. "BUKA" Tiranë.
2. Caktimin e Ekspertes **zj. Silvana Gjikdhima**, Eksperte Kontabël e Autorizuar dhe Ekspertit **z. Emil Nova**, Ekspert Vlerësues, të cilët do të përgatisin Raportin, për përcaktimin e vlerës së paketës shtetërore. Pas përfundimit të vlerësimit Raporti i Ekspertëve do të përcillet për miratim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS).
3. Miratimin e kërkesës së **z. Vladimir Metani**, duke iu kthyer nga shoqëria "BUKA" Sh.a. vlera e investimit të kryer, në masën 120.000 USD.
4. Emërimin e **z. Auron Mëneri** si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për një periudhë 3 (tre) vjeçare, duke u larguar nga kjo detyrë anëtarja aktuale e Këshillit Mbikëqyrës, **znj. Xhilda Qoseja**.
5. Emërimin e **z. Agron Ceka**, si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për një periudhë 3 (tre) vjeçare, duke u larguar nga kjo detyrë anëtari aktual i Këshillit Mbikëqyrës, **z. Albert Kushti**.
6. Autorizimin e **Notere Sofika K. Braka**, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, për të kryer depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Aksionarëve dhe të çdo akti tjetër të nevojshëm për realizimin e këtij qëllimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Ky dokument është foto kopjuar dhe kështu

7. Depozitim e këtij Vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE TË SHOQËRISË
"BUKA" SH.A.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS)
Përfaqësuar nga
Zamir STEFANI

Zamir Stefani
[Signature]

Shoqëria "EURODRINI - DP" Sh.a.
Administratori
Edmir DURAKU

Edmir Duraku
[Signature]
EURODRIN
Company
7 100 P.O. Box 557-724
TIRANE - ALBANIA

Erion ZGURI

Erion Zguri
[Signature]

Arben VAQARRI

Zija MEREPEZA



ky dokument është fletë e kësaj lloji dhe nuk ka vlerë.

**VENDIM I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE
AKSIONAREVE TE SHOQËRISË
BUKA SH.A.**

Tiranë, më date 08 Tetor, 2013 ora 10.00 në Selinë e Shoqërisë BUKA sh.a.

BUKA sh.a., është një shoqëri aksionare Shqiptare, me seli në Rr. Kavajës, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve ("QRA") me NUIS J62013013A ("Shoqëria") dhe me një kapital prej 239,000.000 Lek.

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te Shoqërisë do te behet sipas Rendit te dities si me poshte;

Rendi i Dites:

1. Emerimin e Anetareve te Keshillit te Administrimit te Shoqërisë Buka sha
2. Caktimin i Eksperteve Kontabel te autorizuar te Shoqërisë.
3. Te tjera.

Mbledhja u mbajt dhe filloi ne oren 10:00 ne perputhje me njoftimin e bere nga Shoqëria.

Nga Aksionaret e Shoqërisë ishin prezent:

Z. Lirim Fezollari, mbajtës dhe zotues i 250.723 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 88,56 % te kapitalit te Shoqërisë.

Znj. Arta Hoxha, mbajtese dhe zoteruese e 191 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 0,07 % te kapitalit te Shoqërisë.

Znj. Nazmie Balla, mbajtese dhe zoteruese e 50 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 0,02 % te kapitalit te Shoqërisë.

Mbledhja e Asamblese eshte bere konform ligjit 9901 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ("Ligji Tregtar"), kuorumi i kerkuar nga Ligji Tregtar per mbajtjen e Mbledhjes dhe marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur persa kohe ne mbledhje marrin pjese aksionare qe perfaqesojne te pakten 88,65 % te kapitalit te Shoqërisë.

Aksionaret e Shoqërisë pranuan qe njoftimi dhe mbledhja jane mbajtur ne menyre te rregullt konform afateve dhe menyres se thirrjes te percaktuar nga Ligji Tregtar.

Pasi u bene verifikimet e nevojshme mbledhja u konsiderua e hapur dhe kaloi ne diskutim dhe votim rendin e dities:

PER KETO ARSYE:



Sipas dispozitave ligjore te Statutit dhe te Ligjit Tregtar, Ortaket te pranishem ne Mbledhje:

VENDOSEN

1. Riemërimin e anetareve te keshillit te administrimit si me poshte:

Kryetar i Keshillit te Administrimit: Znj. Brunilda Keco, lindur me 11/06/1982, me karte identiteti nr. 029715289;

Anetar i **Keshillit te Administrimit:** Znj. Laureta Myrtaj, lindur me 10/03/1981, me karte identiteti nr. 029853733;

Anetar i **Keshillit te Administrimit:** Z. Gezim Besholli, lindur me 02/08/1973, me karte identiteti nr. 024500821;

Afati ne detyre i Anetareve te Keshillit te administrimit eshte 3 vjecar, nga dita e Mbledhjes dhe e marrjes se ketij Vendimi. Paga e Kryetarit te Administrimit do te jete vlera e barabarte me 30% te pages mujore te Administratorit te Shoqerise. Paga e anetareve do te jete vlera e barabarte me 15% te pages mujore te Administratorit te Shoqerise.

2. Emerimin ne pozicionin e Eksperteve Kontabel, shoqerine me pergjegjesi te kufizuar Net SPB Kreston me Nipt L42007012I dhe Znj Enkeleca Stefani, lindur ne Tirane, me 13/07/1977, me numer personal H75713046C, dhe numer Nipt-i K72228006I.

3. Autorizimin e Administratorit te Shoqerise te kryeje cdo dhe te gjitha veprimet e nevojshme me qellim zbatimin e ketij Vendimi, pershire leshimin e cdo autorizimi personave per regjistrimin e ketij Vendimi prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, si edhe cdo personi juridik publik ose privat, banka, etj., sipas nevojës.

Aksionarët qe perfaqeson 88,65 %te aksioneve te shoqerise, **Z. Lirim Fezollari, Znj. Arta Hoxha dhe Znj. Nazmie Balla** votojne Pro per te gjitha ceshjet e rendit te dites.

Te Tjera:

Asnje Vencim tjeter nuk u mor ne kete Mbledhje e cila u mbyll ne oren 10:30 ne Tirane, sot me date 08 Tetor 2018.

Z. Gëzim Besholli, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë BUKA sh.a. do të depozitojë këtë Vendim në Arkivën e Shoqërisë dhe ngarkohet të bëjë njoftimet përkatëse tek autoritetet në përputhje me ligjin.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të Shoqërisë

Z.LIRIM FEZOLLARI

AKSIONAR

Zotëues i 250.723 aksioneve me të drejtë vote, ose 83,56 % të Kapitalit të Shoqërisë.

Znj. Arta Hoxha, mbajtëse dhe zotëuese e 191 aksioneve me të drejtë vote që përfaqësojnë 0,07 % të kapitalit të Shoqërisë.

Znj. Nazmie Balla, mbajtëse dhe zotëuese e 50 aksioneve me të drejtë vote që përfaqësojnë 0,02 % të kapitalit të Shoqërisë.

Aksioner i mazhorances

Linim FEZOLLARI

LIRIM FEZOLLARI

Znj. Arta Hoxha

Arta Hoxha

Znj. Nazmie Balla

Nazmie Balla

Nazmie Balla (Beci)



Vendim i Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te

Shoqerise BUKA sh.a.



Tirane, me date 16 Shtator 2015, ora 11:00 ne Seline e Shoqerise BUKA sh.a.

BUKA sh.a. eshte nje shoqeri aksionare e regjistruar ne menyre te rregullt prane Qendres Kombetare te Regjistrimit Tirane, me nr NIPT J62013013A, dhe me nje kapital prej 239,000,000 Lek ("Shoqeria").

Pas perfundimit te procesit te privatizimit te nje pakete aksionesh te zoteruar nga Shteti Shqiptar, eshte kerkuar thirrja e Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te Shoqerise sipas Rendit te Dites se meposhtem:

- Miratimi i Statutit te Ri te Shoqerise.
- Largimi i Anetareve aktuale te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise
- Propozimi, zgjedhja e anetareve te Rinj te Keshillit te Administrimit te Shoqerise.
- Miratimi i Rregullave Proceduriale te Mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve
- Miratimi i Rregullave Proceduriale te Mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve

Mbledhja u mbajt dhe filloi ne ora 11.00 ne perputhje me Njoftimin e bere nga Shoqeria. Noterja Mimoza Sadushi ne hyrje te mbledhjes kreu identifikimin e pjesemarresve ne Mbledhje.

Nga Aksionaret e Shoqerise ishin prezent:

Z. Lirim Fezollari, mbajtes dhe zoterues i 245,818 Aksioneve me te drejte vote, qe perfaqesojne 86,83% te kapitalit te Shoqerise.

Noterja Znj. Mimza Sadushi beri identifikimin e aksionarit prezent ne Mbledhje, duke konstatuar se (i) thirrja dhe mbledhja jane bere konform Ligjit 9901 Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ("Ligji Tregetar"); (ii) kuorumi i kerkuar nga Ligji Tregetar per mbajtjen e Mbledhjes dhe marrjen e vendimeve te vlefshme eshte arritur persa kohe ne mbledhje marrin pjese aksionaret qe perfaqesojne te pakten 86,83% te kapitalit te Shoqerise.

Aksionaret e Shoqerise pruan qe njoftimi dhe mbledhja jane mbajtur ne menyre te rregullt konform afateve dhe menyres se thirrjes te percaktuar nga Ligji Tregetar. Noterja znj. Mimoza Sadushi verifikoi leternjoftimet e personave pjesemarres ne mbledhje.

Mbledhja zgjodhi Kryetar te saj Z. Hysen Caka dhe sekretare te mbledhjes Znj. Aurora Dedndreaj.



Kryetari pas verifikimit të bere nga Noterja Znj Mimoza Sadushaj deklaroi mbedhjen te hapur dhe kerkoi te diskutohej dhe te votohej ne lidhje me rendin e dites.

1. Miratimi i Statutit te Ri te Shoqerise

Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari votoi PRO. Statuti i Ri bashkelidhur MIRATOHET! Nje kopje e Statutit te miratuar i bashkelidhet ketij VENDIMI.

2. Largimi / Shkarkimi i te gjithë Anetareve aktuale te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari votoi PRO. Pika e Rendit te Dites per largimin e Anetareve aktuale te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise MIRATOHET!

3. Propozimi, zgjedhja e anetareve te Rinj te Keshillit Mbikqyres.

Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari propozoi si me poshte vijon per anetare te Rinj te Keshillit te Administrimit te Shoqerise, ne perputhje me Statutin e Ri te Shoqerise:

Kryetar i Keshillit te Administrimit: Znj. Brunilda Keco, lindur me 11.06.1982, me karte Identiteti nr. 029715289;

Anetar i Keshillit te Administrimit: Znj. Laureta Myrtaj, lindur me 10.03.1981, me nr karte identiteti 029853733;

Anetar i Keshillit te Administrimit: Z. Gezim Besholli, lindur me 02.08.1973, me nr karte identiteti 024500821.

Afati ne detyre i Anetareve te Keshillit te Administrimit eshte 3 Vjecar, nga dita e Mbledhjes dhe e marrjes se ketij Vendimi. Paga e Kryetarit te Keshillit te Administrimit do te jete vlera e barabarte me 30% te pages mujore te Administratorit te Shoqerise. Paga e anetareve do te jete vlera e barabarte me 15% te pages mujore te Administratorit te Shoqerise.

Z. Lirim Fezollari, votoi PRO. Kandidaturat propozimet dhe pagesat dhe afatet e percaktuar me siper MIRATOHEN!

4. Shkarkimi i Eksperteve Kontabel aktuale te Shoqerise ZNj. Margarita Kalemasi dhe Znj. Violeta Aloci dhe Propozimi dhe Zgjedhja e Ekspertes Kontabel te Autorizuar te re te Shoqerise.



Z. Lirim Fezollari perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise votoi pro shkarkimit te Eksperteve Kontabel te Shoqerise Znj. Margarita Kalemasi dhe Znj. Violeta Aloci.

Z. Lirim Fezollari propozoi Znj. Enkeleda Stefani me nr NIPT K722280061 dhe nr License 208, duke votuar PRO dhe duke MIRATUAR si Eksperte Kontabel te Shoqerise per nje afat 1 Vjekar, nga dita e mbledhjes, Znj. Enkeleda Stefani.

5. Miratimi i Rregullave Procedurale te Mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve

Kjo Rregullore behet konform Statutit dhe Ligjit Tregetar, per te mundesuar mbajtjen ne menyre te rregullt dhe konform kerkesave te mire-qeverisjes se korporatave te Mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve per Shoqerine. Kjo Rregullore eshte poublikuar me konsultim se bashku me thirrjen e asamblese.

U hodh ne votim kjo pike e Rendit te Dites. Aksionari qe perfaqeson 86,83% te aksioneve te Shoqerise, Z. Lirim Fezollari votoi PRO duke e MIRATUAR tekstin bashkelidhur Procesverbalit.

Te tjera:

Autorizohet Z. Redin Popa, lindur me 23.01.1972, me karte identiteti nr. 028899819 te kryeje regjistrimet perkatese te ketij VENDIMI dhe dokumentave bashkelidhur te miratuara me kete Mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve, prane Qendres Kombnetare te Regjistrimit dhe Qendres se Regjistrimit te Aksioneve ne perputhje me Ligjin.

Dokumentat e miratuara i bashkelidhen ketij Proccesverbali dhe Vendimeve qe do firmosen nga Aksionaret pjesemarres, konform ketij procesverbali. Asnje vendim tjeter nuk u mor ne kete Mbledhje e cila u mbyll ne ora 11:50 ne Tirane, sot me date 16 Shtator 2015.

Asambleja e Pergjithshme e Aksionareve te Shoqerise

Z. LIRIM FEZOLLARI

AKSIONAR

Zoterues i 245,818 Aksioneve me te drejte vote, ose 86,83% te Kapitalit te Shoqerise

LIRIM FEZOLLARI



Hysen Caka
Administrator



**VENDIM I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE AKSIONAREVE TË SHOQËRISË
BUKA SH.A.**



Tiranë, më date 10 Tetor, 2019 ora 10:30 ne Seline e Shoqerise BUKA sh.a.

BUKA sh.a., është një shoqëri aksionare Shqiptare, me seli në Rr. Kavajës, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve ("QRA") me NUIS J62013013A ("Shoqeria") dhe me një kapital prej 239.000.000,00Lek.

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te Shoqerise do te behet sipas Rendit te dites si me poshte;

Rendi i Ditës:

1. Largimi i anëtares Znj.Laureta Myrtaj si pjesë përbërëse e Antarëve të Këshillit të Administrimit.
2. Emerimi i Znj.Blerina Lleshaj si anëtare e re e Këshillit të Administrimit të Shoqërise.
3. Te ndryshme.

Mbledhja u mbajt dhe filloi ne oren 10:30 ne perputhje me njoftimin e bërë nga Shoqeria.

Aksionari i Shumices, Z. Lirim Fezollari eshte caktuar si Kryetari i Mbledhjes se Asamblese, i cili cakton Znj. **Anila Cengu** si sekretare te Mbledhjes se Asamblese.

Nga Aksionaret e Shoqerise ishin prezent:

Z. Lirim Fezollari, mbajtes dhe zoterues i 250.723 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 88,56 % te kapitalit te Shoqerise.

Znj. Arta Hoxha, mbajtese dhe zoteruese e 191 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 0.07% te kapitalit te shoqerise.

Znj. Nazmie Balla, mbajtese dhe zoteruese e 50 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 0.02% te kapitalit te Shoqerise.

Mbledhja e Asamblese eshte bere konform ligjit 9901 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ("Ligji Tregtar")", kuorumi i kerkuar nga Ligji Tregtar per mbajtjen e Mbledhjes dhe marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur persa kohe ne mbledhje marrin pjese aksionare qe perfaqesojne te pakten 88,65 % te kapitalit te Shoqerise.

Aksionaret e Shoqerise pranuan qe njoftimi dhe mbledhja jane mbajtur ne menyre te rregullt konform afateve dhe menyres se thirrjes te percaktuar nga Ligji Tregtar.

Pasi u bene verifikimet e nevojshme mbledhja u konsiderua e hapur dhe kaloi ne diskutim dhe votim rendin e dites:

PER KETO ARSYE:

Sipas dispozitave ligjore te Statutit dhe te Ligjit Tregtar, Ortaket e pranishem ne Mbledhje:

VENDOSEN:

1. Largimi si Anetar i Keshillit te Administrimit te Znj. Laureta Myrtaj, lindur me 10/03/1981, me karte identiteti nr. 029853733;
2. Emerimin si Anetar te Keshillit te Administrimit te Znj. Blerina Lleshaj, lindur me 15/05/1988, me karte identiteti nr personal, I85515081T;
3. Afati ne detyre i Anetares se Keshillit te Administrimit Znj. Blerina Lleshaj do te jete deri me 08/10/2021
4. Z. Gëzim Besholli, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë BUKA sh.a. do të depozitoje kete Vendim ne Arkiven e Shoqerise dhe ngarkohet te beje njoftimet perkatese tek autoritetet ne perputhje me ligjin

Aksionaret qe perfaqeson 88,65 % te aksioneve te shoqerise, **Z. Lirim Fezollari, Znj Arta Hoxha dhe Znj Nazmie Balla** votojne Pro per te gjitha ceshtjet e rendit te dites.

Te Tjera:

Asnje Vendim tjeter nuk u mor ne kete Mbledhje e cila u mbyll ne oren 11:30 ne Tirane, sot me date 10 Tetor 2019

Asambleja e Pergjithshme e Aksionareve te Shoqerise


AKSIONARET

Z. Lirim Fezollari, zoterues i 250.723 aksioneve me te drejte vote, ose 88,56 % te Kapitalit te Shoqerise.

Znj. Arta Hoxha, mbajtese dhe zoteruese e 191 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 0.07% te kapitali te shoqerise.

Znj. Nazmie Balla, mbajtese dhe zoteruese e 50 aksioneve me te drejte vote qe perfaqesojne 0.02% te kapitali te shoqerise.

Aksioner i mazhorances
Z. Lirim FEZOLLARI



Aksionere
Znj. Arta Hoxha



Aksionere
Znj. Nazmie Balla

